



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. _____
Miq. _____
Broj/stranica _____
Pages _____

Nr. Prot. _____
Br.Prot. _____
Prot No. 03-03/1240/18
Data _____
Datum _____
Date 25.04.2018
PRISHTINË

DATË/A:	20.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1182/18
PËR/ZA/TO:	z. Liridon DALIPI Menaxher i zyrë së Prokurimit Radio Televizioni i Kosovës (RTK)
CC:	z. Mentor Shala Drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Sigurimi nga aksidentet personale ne punë për te punësuarit e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/2336/221, nr. të brendshëm RTK/18/254/221.

I nderuari z.Dalipi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: “Sigurimi nga aksidentet personale ne punë për te punësuarit e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/2336/221, nr. të brendshëm RTK/18/254/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: “Sigurimi nga aksidentet personale ne punë për te punësuarit e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/2336/221, nr. të brendshëm RTK/18/254/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat

përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 18 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: AKK-03-03-1082/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sigurimi nga aksidentet personale ne punë për te punësuarit e RTK-së**” me nr. të prokurimit RTK/18/2336/221, nr. të brendshëm RTK/18/254/221, i iniciuar nga autoriteti kontraktues.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 24 muaj, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 60,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiare, është kërkuar në pikën 6. : “*Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në lëmine e shërbimeve të ngjashme me institucion publik dhe privat ne vlerë 90,000.00€*”, si dhe në pikën 7. është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit në origjinal të nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik*”, kërkesa këto për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 68.

Agjenci kundër Korrupsionit, konsideron se kërkesat e lartë cekura janë kërkesa të cilat autoriteti kontraktues duhet ti specifikoj tek kapacitetet teknike dhe profesionale, ku përmes se cilave mund t’i kërkojë nga operatorët ekonomik të ofrojnë dëshmi për të treguar se kanë aftësi teknike dhe profesionale për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa, në rastin konkret autoriteti kontraktues këto kërkesa në njoftimin për kontratë i ka specifikuar ne nenin III.2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiare.

Agjenci kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.
Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

